

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“VILA 135” Sh.P.K

Sot ne daten 01.03.2018, une ortaku i vetem themelues:
Gezim Sijoni, emri i babait Gani, data e lindjes 23.02.1970, lindur ne Shijak-Durres, banues ne Xhafzotaj-Durres, shtetas shqiptar, pajisur me karten e identitetit Nr. H00223168J, madhor, me zotesi juridike dhe zotesi te plote per te vepruar, ne baze te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “VILA 135” Sh.P.K.

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “VILA 135” Sh.P.K dhe eshte person juridik shqiptar.
Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statusi dhe Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.

NENI 2
SELIA E SHOQERISE

SHOQERIA do te kete seline e saj ne:
Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga e “Barrikadave”, Vila 135.
Shoqeria mund te krijojte Filiale, Zyra Perfaqesimi, dege ose agjensi si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3
KOHEZHATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.
Ky afat fillon me rregjistrimin e shoqeriser ne Rregjistrin Tregtar.
Ortaku i shoqerise mund te vendose kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj nje apo disa here, sipas nje vendimi te posacem te marr prej tij.



NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

- Sherbime Hotelerie e te tjera qe lidhen me sherbimin social;
- Bar-restorant;
- Kryerja e sherbimeve turistike dhe organizimit te evenimenteve sipas kerkesave e nevojave te klienteve turiste, vendas apo te huaj, individuale apo te organizuar;
- Venie ne dispozicion te sallave, ambjenteve, per organizimin e konferencave, takimeve te biznesit,veprimtarive lokale, festave familjare etj.;
- Promocioni dhe cdo lloj veprimtarie tjeter e lidhur me sa me siper e te lejuara nga ligji.

Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar, qeradhenes apo dorezanes qe I vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.

NENI 5
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise "VILA 135" Sh.P.K. eshte 100.000 (njqindmije) Leke dhe eshte i perbere nga 1 (nje) kuote me vlere nominale 100.000 (njqindmije) leke.

Ky kapital është i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.

Shoqeria mund te shtoje ose zvogeloje kapitalin ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj sipas vendimit te ortakut te vetem.

NENI 6
ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

- Ortaku i vetem.
- Administratori.

NENI 7
DREJTIMI I SHOQERISE

Ortaku i vetem eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine e ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorit.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.



NENI 8 ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete:

z. Gezim Sijoni, emri i babait Gani, data e lindjes 23.02.1970, lindur ne Shijak-Durres, banues ne Xhafzotaj-Durres, shtetas shqiptar, pajisur me karten e identitetit Nr. H00223168J, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejten rimerimit.

NENI 9 SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE

Viti financiar fillon me date 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarit vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel, miratohen nga eksperti i vetem.

Miratimi i dokumentit mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6-muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Pjesa e fitimit qe i takon ortakut te vetem nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet me vendim te ortakut te vetem.

NENI 10 PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria prishet :

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b) Me vendim te ortakut te vetem.
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit.
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 per "QKR".
- d) Me vendim te gjykates.
- dh) Per arsye te tjera, te parashikuara ne statut.

NENI 11 LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Ortaku i vetem nxjerre vendim te posacem ku emeron nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Ortakut te vetem, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, Likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ortakut te vetem. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar nga ortaku i vetem.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.



NENI 12
PERFUNDIMI I LIKUIDIMIT

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon ç' regjistrimin e shoqerise.
Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas ç' regjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 13
LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat e statutit te shoqerise, si dhe nga te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 14
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente shqiptare.

NENI 15
DISPOZITA E FUNDIT

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 4 (kater) kopje te njejta ne gjuhen shqipe, duke patur secila te njejtat fuqi ligjore dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqerise.

**Emri dhe Nenshkrimi i Ortakut Themelues
te Shoqerise "VILA 135" Sh.p.k**

(Gezim SIJONI)

GEZIM SIJONI
